



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi Parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 27 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Parashtrime mbi kategorizimin sipas rregullës 109(c)
me shtojcën publike 1**

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

1. Në përputhje me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashton rezultatin e konsultimeve me secilin prej ekipeve të mbrojtjes të z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi (së bashku, “Mbrojtja”) në lidhje me kategorizimin që kërkohet sipas rregullës 109(c).²
2. Sikurse shtjellohet në vijim, palët janë pajtuar pjesërisht me qasjen që do të përdoret, por nuk kanë mundur të arrijnë konsensus të plotë në lidhje me këtë çështje.
3. Palët janë pajtuar që brenda 15 ditësh nga dorëzimi i dosjes paraprake të dorëzohet një tabelë sipas formatit në dokumentin bashkëngjitur³. Në përputhje me rregullën 109(c), tabela e propozuar e kategorizon informacionin e nxjerrë në bazë të akuzave në aktakuzë, duke iu referuar konkretisht krimeve bazë, elementeve kontekstuale dhe sjelljes së pretenduar të të akuzuarit. Ajo gjithashtu përmban nënkategori të tjera, sipas pikave të veçanta të aktakuzës dhe formave të përgjegjësisë penale.⁴ Formatit i tabelës së propozuar është në thelb i ngjashëm me atë të miratuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen *Mustafa*.⁵ Sidoqoftë, me kërkesë të njërit nga ekipet e Mbrojtjes, për shkak të një shqetësimi që u shpreh lidhur me kapacitetet e kërkuara për të përmbushur këtë kusht, kolona “Pjesa konkrete në provën e cituar” nuk është e detyrueshme që të plotësohet nga pala që bën nxjerrjen e materialeve.

¹ Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me të, KSC-BC-2020-06/F00099, 23 nëntor 2020, (‘Vendimi kornizë’) para. 99(m).

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor (‘Rregullorja’). Të gjitha referimet në lidhje me “rregulla/rregullat” i referohen Rregullores, përveç nëse saktësohet ndryshe.

³ Shtojca 1 (‘Tabela e propozuar’). Dokumentet e përfshira në tabelën e propozuar dhe përshkrimet e tyre janë dhënë vetëm si shembull dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë prova materiale reale.

⁴ Sa i përket pikave të veçanta të aktakuzës, nëse është praktike, tabela e propozuar do të ketë edhe nënndarje të mëtejshme sipas vendndodhjes/datës, kur është rasti.

⁵ *Shih* Shtojca 1 e Parashtrimin të përbashkët të tabelës së kategorizimit sipas rregullës 109(c), KSC-BC-2020-05/F00045/A01, *miratuar në* Vendimin në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje për apelim, KSC-BC-2020-05/F00046, 5 nëntor 2020.

4. Në përputhje me qasjen e miratuar në çështjen *Mustafa*, ZPS-ja pajtohet që tabelën e propozuar ta dorëzojë brenda afatit të përcaktuar më lart për shkak se përmban, sa i përket ZPS-së, vetëm materiale të nxjerra në përputhje me rregullën 102(1)(b) dhe, sa i përket Mbrojtjes, materiale të nxjerra në përputhje me rregullën 104(1), (5) dhe (6). Kurse mbrojtja e z. Selimi kërkon që tabela e propozuar të përfshijë të gjithë materialet e nxjerra nga ZPS-ja, qoftë sipas rregullës 102 ashtu edhe sipas rregullës 103.

5. Ky zgjerim i konsiderueshëm i përmbajtjes së tabelës së detajuar, ku të përfshihet i gjithë materiali i nxjerrë, nuk do të ishte praktik, sepse do të ishte një barrë tejet e rëndë dhe do të merrte jashtëzakonisht shumë kohë.⁶ E vetmja mënyrë praktike për të krijuar nënkategoritë dhe për të bërë citimet konkrete nga provat që përmban tabela e propozuar, pa i vonuar konsiderueshëm procedurat në tërësi, është që ato të nxirren nga analizat që do të përfshihen në dosjen paraprake. Kjo mënyrë të vepruari nuk do të jetë e mundshme nëse zgjerohet përmbajtja e tabelës së propozuar, siç propozon mbrojtja e Selimit. Qasja e propozuar nga mbrojtja e Selimit do t'i krijonte ZPS-së ngarkesë të konsiderueshme shtesë për analizimin dhe përpunimin e mëtejshëm të materialeve potencialisht voluminoze, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme, me pak ose aspak dobi për përgatitjen e Mbrojtjes ose për procedurat në përgjithësi.

6. Kategorizimet sipas rregullës 109(c) janë menduar thjesht si një mjet shtesë për të ndihmuar palët, Gjykatësin e Procedurës Paraprake, dhe Trupin Gjykes për ta kuptuar materialin e nxjerrë dhe për t'u orientuar gjatë përdorimit të tij.⁷ Këto i shtohen një vargu të gjatë kërkesash ekzistuese, si për shembull, për ZPS-në, identifikimi i rregullës sipas së cilës bëhet nxjerrja e materialeve, dorëzimi i listave të dëshmitarëve dhe të provave në

⁶ Gjithashtu, nëse materiali që është nxjerrë në përputhje me kërkesat individuale të Mbrojtjes sipas rregullës 102(3) do të përfshihej në propozimin e mbrojtjes së Selimit, kjo krijon mundësinë që ekipet e mbrojtjes të mund të kërkojnë edhe tabela të individualizuara.

⁷ Kategorizimet e bëra, qoftë në tabelën e propozuar apo përmes *Legal WorkFlow*, nuk janë detyruese për palën që bën nxjerrjen e materialeve ose për Trupin Gjykes, për sa i përket mënyrës se si do të përdoret materiali apo në lidhje me mbështetjen në atë material. *Shih gjithashtu* rregullat 137(2), 139.

pajtim me kriteret e rregullës 95(4)(b) dhe (c) dhe dorëzimi i dosjes paraprake, ku për secilën akuzë jepet një përmbledhje e provave që do të paraqiten lidhur me kryerjen e krimeve të pretenduara dhe formën/format e pretenduara të përgjegjesisë penale. Për më tepër, çfarëdo mjeti kategorizues që të përdoret, ai nuk mund të zëvendësojë nevojën që pala pranuese ta lexojë materialin e nxjerrë në tërësi.⁸

7. Përveç mjeteve të përshkruara më lart dhe dorëzimit të tabelës së propozuar, ZPS-ja gjithashtu pajtohet që në momentin e nxjerrjes së materialeve dhe për çdo material të nxjerrë – për aq sa është praktike dhe duke përdorur kategoritë e meta të dhënave në *Legal Workflow* – të bëjë kategorizimin e provave për secilën prej katër kategorive të identifikuara në rregullën 109(c) (p.sh. krimet bazë, elementet kontekstuale, sjellja e të akuzuarit dhe/ose, sipas rastit, provat në të cilat do të mbështetet ZPS-ja). Nëse një provë përfshihet në më shumë se një kategori, secila prej tyre do të shënohet. Në kohën e marrjes së paketës me materiale pranuesit do të mund të shohin se në cilat kategori përfshihet secili dokument, t'i filtrojnë dokumentet sipas kategorive, dhe të krijojnë dokumente të eksportueshme në *Excel* sipas atij kategorizimi.

8. Mbrojtja e z. Selimi kërkon që në kohën e nxjerrjes së materialit, si dhe për të gjithë materialin e nxjerrë, ZPS-ja t'i ndajë provat më tej edhe në nënkategori, ndër të tjera, sipas secilës pikë të aktakuzës, vendndodhjes, dhe formave të përgjegjesisë penale.⁹

⁸ *Shih ngjashëm* Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, 18 nëntor 2020, f. 144 dhe 146.

⁹ Shembulli konkret i dhënë nga Mbrojtja e Selimit përmbante:

(a) krimet bazë

(i) lloji i krimit, p.sh. arrestim dhe ndalim arbitrar i paligjshëm

(1) Sedllarë etj.

(b) elementet kontekstuale

(i) krime kundër njerëzimit;

(ii) krime lufte

(c) sjellja e të akuzuarit

(i) ndërmarrje kriminale e përbashkët;

(ii) përgjegjësi eprore, etj.;

(d) Provat që do të paraqiten

i. e lidhur me provën materiale përkatëse

9. Propozimi i Mbrojtjes së Selimit faktikisht kërkon që shkalla e hollësishme e kategorizimit e përdorur në tabelën e propozuar të zbatohet gjithashtu për të gjitha materialet e nxjerra dhe në kohën e nxjerrjes së secilës paketë materialesh. Për arsytet e parashtruara më lart,¹⁰ kjo qasje është përtej mundësive praktike dhe dobia e përgjithshme e saj është shumë e vogël. Për shembull, kjo do të shkaktonte vonesa të menjëhershme dhe shumë të gjata në procesin e nxjerrjes së materialeve dhe për pasojë, Mbrojtja as nuk do të fillonte ta merrte materialin bazë për muaj të tërë.

10. Në formë të përmbledhur, çdo kërkesë për kategorizim sipas rregullës 109(c) nuk duhet të pengojë kryerjen e shpejtë të procedurave në përgjithësi, përfshirë procesin e nxjerrjes së materialeve. Duke pasur parasysh detyrimet e mëdha që ka prokuroria sipas Rregullores lidhur me nxjerrjen e materialeve, përgatitjet për nxjerrjen e materialeve domosdoshmërisht kanë filluar shumë muaj më parë, çka bëri të mundur që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të vendoste shumë shpejt lidhur me kalendarin për nxjerrjen e provave.¹¹ Nëse do të miratoheshin propozimet e paraqitura nga mbrojtja e Selimit, kalendarin e nxjerrjes së provave do të vonohej në mënyrë të konsiderueshme. Kërkesat shitesë të paraqitura nga mbrojtja e Selimit i tejkalojnë së tepërmi kufijtë e asaj që është praktikisht e mundur në këto rrethana¹² dhe të asaj që është e domosdoshme për të lehtësuar përgatitjet e Mbrojtjes, si dhe për të ndihmuar Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe, pas tij, Trupin Gjyqësor, që të kuptojnë dhe mbikëqyrin procesin.

11. Vërejmë se qëndrimi i mbrojtjes së Selimit në lidhje me zgjerimin e përmbajtjes së tabelës së propozuar dhe kërkesën për të bërë nënkategorizime për çdo nxjerrje materialesh, mbështetet tani edhe nga Mbrojtja e z. Thaçi dhe e z. Krasniqi.

¹⁰ Shih paragrafin 5-7.

¹¹ Vendimi kornizë, KSC-BC-2020-06/F00099.

¹² *Shih gjithashtu* Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, 18 nëntor 2020, f. 143-144 dhe 146-147 (ku theksohet nevoja që çfarëdo sistemi kategorizimi i miratuar duhet të jetë praktik dhe të mos vonojë vetë procesin e nxjerrjes së materialeve).

12. Në përputhje me parashtrimet e saj e mëparshme, Mbrojtja e z. Veseli rezervon të drejtën për ta parashtruar qëndrimin e saj më vonë dhe nuk ka dorëzuar parashtrim në lidhje me sistemin e propozuar.

13. ZPS-ja kërkon me respekt nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të vendosë për një qasje e cila përputhet me atë të miratuar në kontekstin e procedurave në çështjen *Mustafa*, duke miratuar që palët, për aq sa është praktikisht e mundshme:

- a. brenda 15 ditësh nga dorëzimi i dosjes paraprake, të dorëzojnë tabela në formatin e paraqitur në shtojcë, sa i përket ZPS-së, të materialeve të nxjerra sipas rregullës 102(1)(b) dhe, sa i përket Mbrojtjes, të materialeve të nxjerra sipas rregullës 104(1), (5) dhe (6); dhe
- b. në kohën e çdo nxjerrjeje të materialeve, të kategorizojnë, duke përdorur kategoritë e meta të dhënave në *Legal WorkFlow*, provat e nxjerra në përputhje me secilën nga katër kategoritë e përcaktuara në rregullën 109(c) (p.sh. krimet bazë, elementet kontekstuale, sjellja e të akuzuarve dhe/ose, sipas rastit, provat në të cilat do të mbështetet ZPS-ja).

Numri i fjalëve në origjinal: 1,414

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E preme, 27 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.